



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Sadri Ferati

Pushtetet lokale po shënojnë një progres të vazhdueshëm dhe po fuqizohen, edhe pse për shtatë vjet qeverisja lokale dalëngadalë për nga kualiteti po barazohet me sistemin në regjion, bile ka fusha ku edhe po dëshmohet se po avancojnë në shumë çështje, ka thënë në një intervistë për Kosovapress, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Sadri Ferati.

Kosovapress: Cilat janë aktivitetet kryesore që ka zhvilluar Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal gjatë muajve të parë të mandatit tuaj?

Ferati: Përveç hartimit të planit 100 ditor, që ishte një prioritet i veprimeve tona, në kuadër të atij plani prioritet kanë pasur draftimi dhe procedimi i ligjeve që kanë të bëjnë me reformimin e pushtetit lokal, decentralizimit, që kanë qenë edhe obligim i ministrisë me marrëveshjen gjithë përfshirëse, e cila është votuar në Kuvend, që tani është dokument i institucioneve të Kosovës që njihet me emrin plani i presidentit Ahtisari, që për fat tani është plan i institucioneve të Kosovës, të cilat ligje ato që kanë qenë detyrë e MAPL-së si ligje të shpejta, siç ka qenë ligji për qeverisje lokale dhe ligji për kufijtë e komunave.

Gjithashtu kemi bashkëpunuar me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe është prezantuar dhe ka kaluar edhe Ligji për financa lokale. Me një punë shumë të ngjeshur të kapaciteteve ministrore dhe bashkë ministrore, pra me Ministrinë e Financave dhe i gjithë kapaciteti mbështetës, të cilin e kemi në kuadër të ministrisë, është bërë një punë e mirë, dhe mendoj se janë prodhuar ligje të mira.

Kosovapress: Cilat janë planet dhe prioritetet e MAPL-së për vitin 2008?

Ferati: Përveç përfshirjes së fushës së përgjegjësive të parapara që janë në kuadër të ministrisë, siç është mbështetja dhe monitorimi i komunave dhe koordinimi i donatorëve dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i programeve për partneritet evropian, në kuadër të këtyre kompetencave prioritet prapë kemi vënë reformimin e pushtetit lokal.

Jemi duke prodhuar përfundimisht edhe planin vjetor që tash është draftuar dhe është në analizat e fundit, deri në fillim të kësaj jave do ta kemi këtë plan, pastaj koncepti dokumenti veprues për implementimin e decentralizimit. Gjithashtu, jemi duke punuar në dokumentin e strategjisë afatmesme të MAPL-së. Në kuadër të kësaj, nevojitet edhe një identifikim i nevojave të komunave për të ndikuar në ngritjen e kapaciteteve nëpër komuna, si në ngritjen e kapaciteteve

të resurseve humane, të vetë zyrtarëve, po ashtu edhe asistencës teknike, në mënyrë që komunat të jenë sa më të gatshme për ta zbatuar reformën plotësisht.

Kosovapress: Keni filluar të zbatoni planin e Ahtisarit në administrimin e pushtetit lokal?

Ferati: Nëse mendohet në nxjerrjen e dokumenteve, përgjigja është po.

Jemi në përfundim e sipërm të nxjerrjes së dokumenteve dhe të planit aksional për implementimin e decentralizimit, pra planit të Ahtisarit. Jemi duke u përgatit në ngritjen e kapaciteteve që komunat të përgatiten sa më mirë. Çështja është se jo në gjithë Kosovën ne kemi komunikim, ngase duhet të kemi bashkëpunim me autoritetet lokale, popullatën, në mënyrë që të mund të instalohen të gjitha këto kompetenca.

Kosovapress: Cilat kompetenca shtesë do të jenë nëpër komuna, veçanërisht në komunat në të cilat përfshihen në decentralizim?

Ferati: Përveç kompetencave ekzistuese që do të përfshihen edhe në komunat e reja dhe tri pilot-njësitë që edhe ato planifikohen të shënohen nëpër komuna, kompetenca shtesë për të gjitha këto komuna do të jenë edhe kompetencat e çështjeve sociale, ato në shërbime publike, siç është ujësjellësi, skema e ngrorjes, trafiku urban, pastrimi dhe trajtimi i burimeve të ngurta dhe menaxhimi i tregjeve. Këto do të jenë kompetenca shtesë në krahasimin me kompetencat dhe organizmin momental të pushteteve lokale.

Kosovapress: A do të ketë edhe pilot-njësitë dhe cilat kritere duhet t'i plotësojnë ato për të marrë statusin e pilot-njësisë?

Ferati: Para se të krijohen pilot-njësitë ka pasur kritere dhe është bërë përzgjedhja se ku do të pilotohen dhe ku do të shkohet me pilot-njësi dhe vendimet janë marrë shumë më herët. Në fazën që jemi kriteri i vetëm do të jetë një performancë e pilot-njësisë për të parë sa janë aftësuar deri në masën që ato do të mund vetvetiu të qeverisin dhe të krijojnë shërbime të domosdoshme të dobishme për qytetarët e atij lokaliteti.

Kosovapress: A është bërë ndonjë analizë rreth asaj se si kanë funksionuar këto pilot-njësi në fazën e parë, përkatësisht a e kanë kaluar testin për të ecur më tutje?

Ferati: Deri më tani gjatë gjithë fazës së monitorimit dhe kontakteve dhe mbështetjes ekziston një vlerësim pozitiv se që të tri pilot-njësitë kanë bërë një avancim në menaxhimin e gjithë fushës së përgjegjësive të tyre. Deri tani jemi të kënaqur, por do të vazhdojmë akoma që të monitorojmë, të bashkëpunojmë dhe t'i ndihmojmë në çdo aspekt këto tri pilot-njësi, në mënyrë që të jenë sa më të fuqishme deri në momentin kur ato marrin përgjegjësitë si një komunë me të gjitha kompetencat e plota.

Kosovapress: Sa komuna të reja do të jenë?

Ferati: Në krahasim me skenën momentale do të jenë 5+1 komuna, do të thotë Artana që është plus që zgjerohet territorialisht, pesë komuna të reja me shumicë serbe, Parteshi, Ranilluku, Graçanica, Mitrovica veriore dhe tri pilot-njësitë do të jenë gjithsej plus tetë. Nga 30 komuna që kanë ekzistuar deri më tash në Kosovë, tani do të jenë 38.

Kosovapress: Kur do të fillojë funksionimi i këtyre komunave të reja dhe cila do të jetë kostoja e tyre buxhetore?

Ferati: Jemi duke biseduar rreth koston buxhetore. Ministria për Ekonomi dhe Financa e ka nxjerrë koston. Kjo është çështje që ata janë në përpjekje e sipër, diçka nga buxheti, diçka nga konferenca e donatorëve. Fillimi do të jetë se çdo komunë do të instalohet në zgjedhjet e reja. Deri atëherë, ne do të bëjmë përgatitjet, formimin e grupeve, të cilat do të përgatisin komunën deri në zgjedhje. Pas zgjedhjeve do të legjitimohen strukturat komunale.

Kosovapress: Si është duke funksionuar pushteti lokal nëpër komuna dhe çfarë janë raportet e komunikimit të ministrisë që ju drejtoni me komunat me shumicë serbe?

Ferati: Pushteti lokal në përgjithësi është duke funksionuar mirë. Jemi të kënaqur. Gjithashtu, kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me kornizat e gjashtë komunave. Po vazhdojmë të bëjmë përpjekje shtesë që të fuqizohet vetëqeverisja lokale. Shihet një tendencë e vazhdueshme që në Kosovë, pushtetet lokale të kenë kompetenca të shtuara dhe të kemi autonomi të plotë të qeverisjes lokale.

Ndërsa, në katër komunat, në tri komunat e pjesës veriore dhe me Shtërpcën nuk kemi ndonjë komunikim, ngase është një refuzim i tyre për të bashkëpunuar me strukturat e UNMIK-ut dhe Ministrinë e Administrimit Pushtetit Lokal, por ne do të ofertojmë vazhdimisht që të krijohet ky komunikim dhe është një domosdo që MAPL ta shtrijë ndikimin e vet dhe ndihmën në dobi të atyre pushteteve lokale, të qytetarëve në çdo pjesë të territorit të Kosovës.

Kosovapres: Cili është mesazhi juaj për komunat dhe administrimin e pushtetit lokal?

Ferati: Pushtetet lokale po shënojnë progres të vazhdueshëm dhe po fuqizohen, edhe pse për shtatë vjet qeverisja lokale dalëngadalë për nga kualiteti po barazohet me sistemin në regjion. Bile, ka fusha ku ajo edhe po dëshkohet se po avancohet në shumë çështje. Kjo është edhe një thirrje për të gjithë qytetarët e Kosovës, që t'i pranojnë kompetencat e veta që të ushtrojnë pushtetin dhe komunat me shumicë shqiptare dhe ato me shumicë serbe, sepse ajo është në interesin e tyre. MAPL është për të implementuar kompetencat e veta në fushën e monitorimit dhe të ndihmojë ato komuna, por edhe në bashkëpunimin me zyrën mbështetëse që e kemi këtu, si dhe në koordinimin me donatorë, në mënyrë që ato pushte të fuqizohen dhe ata qytetarë të përfitojnë sa më tepër nga vetëqeverisja./Intervistoi: Shpresa Përvetica/